

## NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata Themelore në Prizren, Departamenti i përgjithshëm, gjyqtari i vetëm gjykues Luan Berisha, me pjesëmarrjen e sekretares juridike Naxhis Sharani procesmbajtëse, në çështjen penale ndaj të akuzuarit M. Sh., nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës, sipas aktakuzës të Prokurorisë Themelore në Prizren PP.nr. 3062/2015 të datës 15.02.2016, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar në prezencën e Prokurorit të shtetit në Prizren Sahide Sefa, të akuzuarit, dhe të dëmtuarës V. Sh., me datë 18.01.2017, mori dhe publikisht shpalli këtë:

### A K T G J Y K I M

#### I akuzuari

**M. SH.**, nga i ati R. dhe nëna R. e lindur B., i lindur me datë *data e lindjes.....*, në fshatin S., Komuna e P., ku edhe tani jeton, ka të kryer shkollën e shurdhmemecëve, i gjendjes së dobët ekonomike, boshnjak, shtetas i republikës së Kosovës.

### Ë S H T Ë F A J T O R

Me datë 02.10.2015, rreth orës 10,00 minuta, në fshatin S., Komuna e P., saktësisht në shtëpinë familjare të përbashkët, i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarën V. Sh., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale ndërmjet tyre situata del jashtë kontrollit me ç' rast i pandehuri reagon duke e kapur për flokë të dëmtuarën dhe duke e detyruar që ta lëshonte shtëpinë,

- këso dore ka kryer veprën penale sulmi nga neni 187 par.1 të KP-së,

Andaj gjykata në kuptim të nenit 7, 41,43 par.1 pika 1.3, 46, 73, 74, 75, 76 dhe nenit 188 par.1 pika 1.1. të KP-ës, të akuzuarit i shqipton:

### DENIM ME KUSHT

Vërteton dënimin me burgim në kohëzgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një viti, nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryer vepër të re penale.

Obligohet i akuzuari që të paguaj shpenzimet e paushallit gjyqësor në shumën prej 20,00 Euro, të gjitha këto në afat prej 15 ditësh nga dita e plotfuqishmërisë së këtij aktgjykimi nën kërcënim të ekzekutimit të dhunshëm.

## A r s y e t i m

Prokuroria themelore në Prizren, ka parashtruar aktakuzën PP.nr.3062/2015 të datës 15.02.2016, kundër të akuzuarit M. Sh., nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale të sulmit, nga neni 187 par.1 të KP-ës.

Prokurori i shtetit Sahide Sefa në fjalën e saj përfundimtare deklaroi: mbës në tërësi pranë aktakuzës PP.nr.3062/2015 të datës 15.02.2016, të parashtruar ndaj të pandehurit M. Sh., nga fshati S., Komuna e P., për shkak të veprës penale sulm nga neni 187 par.1 të KP-së, e tërë kjo ngase në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi u vërtetua gjendja faktike e përshkruar në dispozitiv të aktakuzës, e kjo nga vet pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, i cili në mënyrë vullnetare e pranoi fajësinë për veprën penale e cila i vihet në barë, si dhe në bazë të provave tjera që gjenden në shkresat e lëndës. Andaj propozoj gjykatës që i njëjti të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit, paraprakisht duke i marrë për bazë rrethanat lehtësuese dhe ato rënduese.

E dëmtuara V. Sh., deklaroi si palë e dëmtuar nuk parashtron kërkesë pronësoro juridike, pasi që të akuzuarin e ka kumatë – vëlla të bashkëshortit.

I akuzuari M. Sh., në fjalën e tij përfundimtare deklaroi: e pranoi në tërësi veprën penale e cila më vihet në barë me aktakuzën të ngritur ndaj meje, unë në ditën kritike kam qenë nervoz dhe nuk e di as vet se si kam vepruar në atë mënyrë, të dëmtuarën e kam kumatë, me të njëjtën jemi në raporte të shëndosha e njëjta është bashkëshortja e vëllaut tim, i kërkoj falje sot para gjykatës të njëjtës, dhe i premtoj gjykatës që në të ardhmen do të jem më i kujdesshëm dhe do të përmbahem nga veprimet e tilla, e po ashtu i propozoj gjykatës që si rrethana lehtësuese të marr faktin se kjo është hera e parë që kam ardhur në konflikt me ligjin, si dhe moshën time të re në momentin e kryerjes së veprës penale, të gjitha këto rrethana konsideroj dhe i propozoj gjykatës që të ketë parasysh me rastin e marrjes së vendimit mbi llojin dhe lartësinë e dënimit.

Gjykata në shqyrtimin fillestar ka vërtetuar këtë gjendje faktike.

Me datë 02.10.2015, rreth orës 10,00 minuta, në fshatin S., Komuna e P., i akuzuari saktësisht në shtëpinë familjare të përbashkët, i pandehuri e ka sulmuar të dëmtuarën V. Sh., në atë mënyrë që pas një mosmarrëveshje fillimisht verbale ndërmjet tyre situata del jashtë kontrollit me ç' rast i pandehuri reagon duke e kapur për flokë të dëmtuarën dhe duke e detyruar që ta lëshonte shtëpinë,

Gjykata gjendjen e këtyre faktike e ka vërtetuar nga pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit i cili në shqyrtimin fillestar vullnetarisht ka pranuar fajin, për shkak të cilës gjykata fare nuk ka administruar provat. Sipas detyrës zyrtare gjykata nuk gjeti se ekziston ndonjë provë e pa pranueshme, gjithashtu gjykata në tërësi ka vërtetuar se i akuzuari M. Sh., ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimi të fajit për veprën penale e cila i vihet në barrë e që pranimi i fajit është bërë në mënyrë vullnetare dhe pa kushtëzim dhe mbështetet në fakte dhe prova materiale të cilat janë paraqitur në aktakuzë, për të cilat i akuzuari ka qenë i njoftuar me të gjitha provat materiale. Gjykata ka ardhur në përfundim, se pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit është bërë në pajtim me nenin 248 të KPP-ës, dhe faktet që përmban aktakuza, në veprimet e të akuzuarit,

formohet të gjitha elementet e veprës penale të sulmit nga neni 187 par.1 të KP-ës, paraprakisht duke e vërtetuar përgjegjësin e tyre penale juridike.

Me rastin e marrjes së dënimit ndaj të akuzuarit gjykata vlerësoj të gjitha rrethanat në kuptim të dispozitave të nenin 73 të KPK-ës të cilët ndikojnë në zgjedhjen e llojit dhe lartësisë së dënimit, duke mos gjetur rrethanat rënduese e që si rrethanë lehtësuese është marrë pranimi i fajësisë nga ana e të akuzuarit, pendimi i thellë e të akuzuarit, sjellja korrekte pas kryerjes së veprës penale, mosha e të akuzuarit, më herët nuk ka qenë i dënuar, çka nënkupton se nuk ka ardhur ndesh me rregullat pozitive. Po ashtu konform nenit 74 gjykata mori parasysh edhe rrethanat personale të akuzuarit dhe karakterin e tij, moshën e të njëjtit, bashkëpunimin e përgjithshëm me gjykatën, pranimin e fajësisë, keq ardhjen e shfaqur si dhe sjelljen e të akuzuarit pas konfliktit, andaj gjykata i shqipton dënimin me burgim kohë zgjatje prej 6 (gjashtë) muajve, cili dënim nuk do të ekzekutohet në afatin prej 1 (një) viti nga dita e plotfuqishmërisë të këtij aktgjykimi, nëse i akuzuari nuk kryen veprë të re penale, duke menduar se dënimi i shqiptuar i përgjigjet shkallës së përgjegjësisë së tij, dhe se me këtë dënim do të arrihet qëllimi i dënimit që në të ardhmen të jetë më të kujdesshëm dhe do të përmbahet nga veprimet e tilla.

Vendimi mbi shpenzimet e paushallit gjyqësor gjykata e bazoi në kuptim të nenit 450 dhe 451 të KPP-ës.

Nga të cekurat më lart u vendos si në shqiptim të këtij aktgjykimi.

**GJYKATA THEMELORE NË PRIZREN**  
**P.nr.374/2016 me datë 18.01.2017**

**Procesmbajtësja**  
**Naxhis Sharani**

**Gjyqtari**  
**Luan Berisha**

**UDHËZIM JURIDIK:** Kundër këtij aktgjykimi pala e pa kënaqur ka të drejtë ankesë në afat prej 15 ditësh nga dita e marrjes së të njëjtës, Gjykatës së Apelit në Prishtinë, nëpërmjet të kësaj gjykate.